FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.38 3 prill 2007

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.144, datë 22.3.2007	Për lejimin e kalimit transit të disa trupave ushtarake sllovene, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë.....	1053
Vendim i KM nr.145, datë 27.3.2007	Për lejimin e kalimit transit të disa trupave ushtarake italiane, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë.....	1053
Vendim i KM nr.158, datë 22.3.2007	Për miratimin e fondit limit të shpenzimeve të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit, për vitin 2007.....	1054

VENDIM
Nr.144, datë 22.3.2007

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANSIT TË DISA TRUPAVE USHTARAKE SLLOVENE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, e 18 e 19, të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit transit të 4 (katër) trupave dhe 2 (dy) mjeteve ushtarake sllovene, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Durrës-Qafë-Thanë, në datën 26.3.2007.

Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të jetë pika e kalimit të kufirit, Durrës.

Pika daljes të jetë pika e kalimit të kufirit, Qafë-Thanë.

2. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në/nga Republika e Shqipërisë janë parashikuar në "Marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave", nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, dhe në "Marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre", nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe në protokollin shtesë të "Marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktaktin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera, pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre", ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

3. Trupat sllovene, gjatë itinerarit të lëvizjes, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

4. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.145, datë 27.3.2007

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANSIT TË DISA TRUPAVE USHTARAKE ITALIANE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19, të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit transit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, të 7 (shtatë) trupave dhe 1 (një) mjeti ushtarak italian, në itinerarin Qafë-Thanë-Durrës, në datën 27 mars 2007, dhe lejimin e kalimit transit të po këtyre trupave dhe mjetit, në datën 30 mars 2007, në itinerarin Durrës-Qafë-Thanë.

Për trupat ushtarakë, që kalojnë në datën 27 mars, pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë është pika e kalimit kufitar, në Qafë-Thanë, dhe pika e daljes është pika e kalimit kufitar, në Durrës, ndërsa në datën 30 mars 2007, pika e hyrjes është pika e kalimit kufitar, në Durrës, dhe pika e daljes është pika e kalimit kufitar, Qafë-Thanë.

2. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në/nga Republika e Shqipërisë janë parashikuar në "Marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave", nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, dhe në "Marrëveshjen ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre", nënshkruar në Bruksel, në 10 janar 1994, si dhe në protokollin shtesë të "Marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera, pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre", ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

3. Trupat italiane, gjatë itinerarit të lëvizjes, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

4. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.158, datë 22.3.2007

PËR MIRATIMIN E FONDIT LIMIT TË SHPENZIMEVE TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIOS DHE TELEVIZIONIT, PËR VITIN 2007

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin, publik e privat, në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fondit limit të shpenzimeve të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizonit, për vitin 2007, në shumën 66 000 000 (gjashtëdhjetë e gjashtë milionë) lekë, shpenzime korente, dhe 28 300 000 (njëzet e tetë milionë e treqind mijë) lekë, shpenzime për investime.

2. Ngarkohet Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga datat 1.1.2007

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare
ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark",
prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. **KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
2. **KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
3. **REGJISTRAT E NOTERISË**
4. **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**

1.	**PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006)…….....**	**1500**
2.	**PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005) …….....**	**600**
3.	**PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....**	**1300**
4.	**PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT…….....**	**500**

Botime të reja

1	**TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)…....….....**	**1000**
2	**TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)…....….....**	**500**
3	**TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)…….….....**	**1000**
4	**TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)…….….....**	**500**
5	**PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË…….....**	**1000**
6	**PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR……**	**800**
7	**PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET…….....….....**	**500**
8	**PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006)……**	**1000**
9	**PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE…….....**	**500**

Hyri në shtyp më 3.4.2007
Doli nga shtypi më 3.4.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja "Grafon"
Tiranë, 2007

Çmimi 6 lekë